



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:113772
Datë: 15.05.2024
Numri i dokumentit: 05691002

C.nr.379/20

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj, në çështjen juridike kontestuese të paditësve-propozuesve V.A., nga fshati komuna e Klinës, T.M., nga fshati komuna e Gjakovës, H.Th., nga fshati ... komuna e Pejës, H.K., nga fshati ... komuna e Gjakovës dhe Z.K., nga fshati komuna e Gjakovës, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Isa Osdautaj, avokat nga Deçani, kundër të paditurve-kundërshtarëve të sigurimit M.K., N.K., P.K., N.K., P.K., që të gjitha nga fshati ..., komuna e Deçanit të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Binak Cena, avokat nga Peja dhe të paditurit –kundërshtart të sigurimit F.K., nga fshati ..., komuna e Deçanit me objekt kontesti vërtetim i së drejtës së pronësisë, jashtë shqyrtimit, me datë 15.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. ABROGOHEN të gjitha veprimet e ndërmarra nga kjo gjykatë në seancën dëgjimore të datës 18.04.2024.
- II. NDËRPREHET procedura në këtë çështje kontestimore për shkak të vdekjes së paditëses-propozueses V.A., ish nga fshati, komuna e Klinë dhe vdekjes së të paditurit-kundërshtarit të sigurimit P.K. ish nga fshati, komuna e Deçanit.
- III. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët ta zgjidhin trashëgiminë apo kur kujdestari i pasurisë trashëgimore e marrin për sipër procedurën, apo kur gjykata i thërret ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare, apo kur gjykata në bazë të propozimit të palës së kundërt kërkon që palët të vazhdojnë procedurën.

A r s y e t i m

Fillimisht në këtë gjykatë paditësit-propozuesit L.K., V.H., T.M., H.Th., NK., Z.K., kishin paraqitur padi kundër të paditurve-kundërshtarëve të sigurimit M.K., N.K., P.K., N.k., P.K., dhe F.K., që të gjitha nga fshati ..., komuna e Deçanit, me bazë juridike vërtetim i së drejtës së pronësisë me propozim për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata, përmes Aktvendimit C.nr.203/2018, të datës 10.02.2020, kishte ndërprerë procedurën gjyqësore në këtë çështje kontestimore për shkak të vdekjes së paditëses-propozueses L.K.,

Trashëgimtare e paditëses L.K., tani paditësit, në këtë gjykatë me datë 29.05.2020 kanë bërë kërkesë për vazhdim të procedurës së ndërprerë me aktvendimin e sipërcituar.

Gjykata, pasi që ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për vazhdim të procedurës, me datë 18.04.2024 ka marrë aktvendim për vazhdim të procedurës, e që në seancën dëgjimore të po të njëjtës ditë, ka konstatuar të tërhequr propozimin për caktim të masës së sigurisë, duke kaluar në seancë përgatitore për shqyrtim të padisë.

Në seancën përgatitore të datës 18.4.2024, i padituri F.K., ka njoftuar gjykatën e çështjes së pas paraqitjes së kërkesës për vazhdim të procedurës kanë vdekur paditësja V.A., dhe i padituri P.K., e që gjykata ka obliguar përfaqësuesit e palëve që të sjellin prova rreth vdekjes së të njëjtëve.

I autorizuari i paditësit, avokati Isa Osdautaj, në këtë gjykatë me datë 30.04.2024, ka paraqitur një parashtrësë duke e njoftuar gjykatën për vdekjen e paditëses V.A., dhe të paditurit P.K., duke i bashkangjitur edhe Certifikatat e vdekjes për të njëjtët.

Gjykata nga Certifikata e Vdekjes me numër serik V 10678589, numër reference 8/2020RV/8010 dhe numër rendor 14, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, ka konstatuar faktin se paditësja V.A., ka ndërruar jetë me datë 28.11.2020. Po ashtu nga Certifikata e Vdekjes me numër serik V 10678598, numër reference 2/2024RV/2001 dhe numër rendor 96, ka konstatuar faktin se i padituri P.K. ka ndërruar jetë me datë 27.02.2024.

Andaj, gjykata meqenëse në seancën dëgjimore të datës 18.04.2024 ka konstatuar të tërhequr propozimin për caktim të masës së sigurisë vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi. E po ashtu duke qenë se në shkresat e lëndës nuk posedon aktvendim të trashëgimisë, sipas të cilit do të vërtetohej se trashëgimia ndaj tani të ndjerës V.A. dhe të ndjerit P.K., ka përfunduar në formë të prerë, atëherë në kuptim të nenit 95, lidhur me nenin 277 nën par. a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr.38/2008 të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, vendosi si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.379/20, datë 15.05.2024

Gjyqtarja
Fëllanza Knushaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.